



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 054

Prishtinë, më 19 dhjetor 2008, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 19 DHJETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi** anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 83 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009.

Kryetari i njoftoi deputetët lidhur me Raportin e Komisionit FunkSIONAL dhe raportues.

Ai ftoi kryetarin e këtij Komisioni që ta paraqesë para Kuvendit Raportin me rekomandime.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni më shumë se një muaj është marrë me Projektbuxhetin për vitin 2009, e ka përfunduar punën e vet dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me amendamentet.

Kryetari i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74;
Kundër-----21;
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin nr. 03/L-105 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, i falënderoi deputetët e Kuvendit për miratimin e Buxhetit të vendit për vitin 2009.

Ai propozoi që Kuvendi ta miratojë edhe Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Kryetari hodhi në votim propozimin e kryeministrit. Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin e Kryeministrit të Kosovës.

Kryetari tha se seanca tjetër për miratimin e Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës do të mbahet sot, në orën 16:00.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale